REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr._____ Prot. Tiranë, më ___. ___. 2023

Lënda: Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - dhjetor 2022

KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Tiranë

Të nderuar anëtarë,

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 115, datë 25.11.2021,"Për buxhetin e vitit 2022", udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", është hartuar për shqyrtim dhe miratim nga Grup i Menaxhimit Strategjik, relacioni dhe formatet standarde, si pjesë e strukturës së raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar - dhjetor 2022.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimit i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar- dhjetor 2022, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt sa i përket produkteve të përcaktuar dhe zërave të shpenzimeve, dhe planifikimit të buxhetit në PBA-në (2022-2024).

Në kërkesat buxhetore për vitin 2022, Kolegji i Posaçëm të Apelimit, ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, "Çështje të ankimuara/shqyrtuara" me një plan vjetor në masën 70 çështje. Gjatë periudhën janar - dhjetor 2022, Kolegji ka marrë në shqyrtim 55 çështje me një realizim prej 78.6 %.

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në zbatim të ligjit nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 dhe shtesës së miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 19245/1 prot., datë 02.11.2022, janë përcaktuar në vlerën ***197.9 milionë lekë*** dhe realizimi ***197.1 milionë lekë*** ose ***99.6 %***.

Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesore, paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë

Llogaria ekonomike	Emertimi	Plani vjetor (fillestar)	Plani vjetor (i rishikuar)	Realizimi vjetor	% realizimit
6000000	Paga	161.700	159.747	159.624	99.9%
6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetsore	13.660	12.951	12.951	100.0 %
6020000	Mallra dhe shërbime	24.000	15.052	15.044	100.0 %
6060000	Trans per Buxh. Fam. & Individ	264	8.190	8.151	99.5 %
2310000	Investime Kapitale	2,000	2.000	1.355	67.8 %
	Totali	**201.624**	**197.940**	**197.125**	**99.6 %**

I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Buxheti i miratuar në paga, pas ndryshimeve për vitin 2022, është ***159.7 milionë lekë*** dhe përbën 80.7 % të buxhetit total vjetor. Realizimi për periudhën janar- dhjetor 2022, është ***159.6 milionë*** lekë ose 99.9 %, të planit vjetor.

Kjo vlerë përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 57 (pesëdhjetë e shtatë) punonjës, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 35/2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit" dhe pagat për 6 (gjashtë) punonjës me kontratë të përkohshme përcaktuar në VKM-në nr. 35, datë 19.01.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022.

Gjithashtu gjatë vitit 2022, janë kryer pagesat e efektit prapaveprues sipas rekomandimit të KLSH-së, për periudhën qershor 2017- shkurt 2021, për pagat e gjyqtarëve dhe këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor, si dhe pagesa e vështirësisë në masën e 2(dy) pagave mujore, për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, sipas vendimeve të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 74, datë 27.07.2022 dhe nr. (92-109), datë 07.12.2022.

II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Buxheti i rishikuar për vitin 2022 në sigurime shoqërore dhe shëndetësore është ***12.9 milionë lekë*** dhe përbën 6.5 % të buxhetit total vjetor. Realizimi për periudhën janar- dhjetor 2022, është ***12.9 milionë*** lekë ose 100 % të planit vjetor. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihen një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar me ligjin nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", në shpenzime operative për vitin 2022, është ***24 milionë lekë***,

Buxheti i rishikuar pas ndryshimeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, dhe miratimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të kërkesave të Kolegjit me nr. 299 prot., datë 18.02.2022, nr. 1516 prot., datë 08.11.2022, si dhe nr. 1705 prot., datë 30.12.2022, për transferim të fondeve brenda programit buxhetor, është ***15.1 milionë lekë*** dhe përbën 7.6% të buxhetit total vjetor.

Realizimi i shpenzime operative, për periudhën janar- dhjetor 2022, është ***15.1 milionë lekë*** ose 100 %.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim:

MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	**Realizimi viti 2022 (në lekë)**
Shpenzime për materiale pastrimi e higjeno-sanitare	**495.600**
Shpenzime për kancelari, letër, tonera	**2.831.866**
Shpenzime për blerje ujë të pijshëm	**144.530**
Shpenzime për energji elektrike	**1.507.824**
Shpenzime për furnizimin me ujë nga rrjeti i ujësjellësit	**54.900**
Shërbime telefonie celulare dhe fikse	**653.386**
Shërbim postar dhe abonim në shtypin e shkruar	**193.791**
Shpenzime për publikimin në mediat e shkruara të shpalljeve të vendeve vakante	**811.200**
Shpenzime për uniforma për seanca gjyqësore	**100.000**
Shpenzime për prodhim dokumentacion specifik	**78.000**
Shpenzime qiramarrje ambiente pune	**238.000**
Shpenzime për materiale elektrike, hidraulike, pjesë këmbimi fotokopje	**266.450**
Shpenzime mirëmbajtje sistem video, pajisje zyre	**217.200**
Shpenzime mirëmbajtje faqes zyrtare	**40.000**
Shpenzime për karburant për automjetin e institucionit	**271.197**
Shërbime për automjetin e institucionit	**374.180**
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	**386.638**
Shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës	**6.126.700**
Shpenzime për tatim dhe taksa për institucionin	**61.853**
Shpenzime për blerje licensash për software	**101.684**
Shpenzime te tjera	**96.182**
TOTALI	**15.051.181**

Janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale dhe shërbime të nevojshme gjatë aktivitetit të përditshëm të institucionit ku përfshihen shpenzime për kancelari, letër A4, tonera për pajisjet e printimit, materiale pastrimi dhe dezinfektimi, në vlerën 3.327.466 lekë.

Janë shlyer detyrimet lidhur më shpenzimet për energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse, si dhe publikime në media të vendeve të shpallura vakante në institucion, për një vlerë totale 2.762.028 lekë.

Janë kryer shpenzime për telefoninë celulare për Kryetaren e Kolegjit, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe drejtuesve të administratës, sipas kuotës mujore, përcaktuar me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, në vlerën 603.603 lekë.

Janë kryer shpenzime për prodhimin e togave gjyqësore për gjyqtarët e Kolegjit, si dhe për prodhimin e maskave për mbrojtje nga Covid -19, me logon e institucionit si dhe prodhim dokumentacioni specifik (dosje gjyqësorë) në vlerën 178.000 lekë.

Duke filluar nga muaji tetor 2022, janë kryer shpenzime për ambientet shtesë të kontraktuara nëpërmjet qiramarrjes, ku aktualisht janë vendosur përkthyesit dhe magazina e institucionit në vlerën 238.000 lekë.

Janë kryer shpenzime për blerje materiale elektrike, hidraulike si dhe pjesë këmbimi për pajisjet fotokopjuese me vlerë totale 266.450 lekë.

Janë kryer shpenzime për mirëmbajtjen periodike të sistemit video, faqes zyrtare të institucionit si dhe pajisjeve fotokopjuese me vlerë totale 257.200 lekë.

Janë kryer shpenzime për automjetin e institucionit duke përfshirë furnizimin me karburant, mirëmbajtjen, sigurimin, pastrimin dhe vend parkimin me vlerë totale 645.377 lekë.

Janë kryer shpenzime për dy udhëtime pune jashtë vendit të Kryetarit të Kolegjit në vlerën 386.638 lekë.

Janë kryer shpenzime që i përkasin kontratave të lidhura për sigurimin e jetës, shëndetit, për gjyqtarët e Kolegji, personave të lidhur të tyre, këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe stafit administrativ për një vlerë totale 6.126.700 lekë.

Janë kryer shpenzime për pagesën e taksave vendore të institucionit dhe derdhjes së tatimit në burim për ambientet me qira në vlerën 61.853 lekë.

Janë kryer shpenzime për rinovimin e licensave të përdorimit të platformës "Zoom Meeting" dhe "Microsoft Office 365" për ruajtjen dhe transmetimin e dokumentacionit me ONM-në në vlerën 101.684 lekë.

Janë kryer shpenzime të tjera në vlerën 96.182 lekë, ku përfshihen kolaudimi e rimbushja e fikseve të zjarrit, karta aksesi kompensime për pasaporta diplomatike etj.

IV - Shpenzimet për Trans per Buxh. Fam. & Individ (llogaria ekonomike 606)

Buxheti i miratuar me ligjin nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022" këtë kategori shpenzimesh për vitin 2022, është në vlerën ***264 mijë lekë***

Buxheti i rishikuar pas ndryshimeve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është ***8.2 milionë lekë*** dhe përbën 4.1% të buxhetit total vjetor. Realizimi i shpenzime për këtë kategori shpenzimesh, për periudhën janar- dhjetor 2022, është ***8.2 milionë lekë*** ose 100 % të planit vjetor dhe përfshin:

Shpenzime për rimbursimin e shpenzimeve telefonike të gjyqtarëve sipas përcaktimit në VKM nr. 673, datë 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publik", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, në vlerën 651.371 lekë.

Pagesën prej 1(një) page mujore, në vlerë 50.715 lekë, për një rast dalje në pension, pagesën në vlerë 50.000 lekë, si ndihmë financiare për një rast sëmundje, si dhe pagesën në vlerën 60.000 lekë, si ndihmë financiare për dy raste fatkeqësie në familje, sipas përcaktimeve në VKM nr. 929, datë 17.11.2020 " Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar.

Gjithashtu në këtë kategori shpenzimesh është përfshirë dhe pagesa në vlerën 7.4 milionë lekë, si ndihmë financiare e menjëhershme, për gjyqtarët dhe personelin e Kolegjit sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 898, datë 29.12.2022 dhe vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 112, datë 30.12.2022.

V. Investime kapitale (231)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2022 në investime është ***2 milionë lekë*** dhe përbën 1 % të buxhetit total vjetor. Ky buxheti nuk ka pësuar ndryshime gjatë vitit dhe realizimi për periudhën janar- dhjetor 2022, është rreth ***1.4 milionë lekë*** ose 67.7 %.

Këto fonde janë parashikuar për plotësimin e nevojave për punonjësit shtesë në strukturën organike (miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 35/2022), me pajisje elektronike (kompjuter, laptop printer, ups, etj) në vlerën 1.2 milion lekë dhe pajisje dhe mobilje zyre në vlerën 800 mijë lekë.

Gjatë vitit 2022, janë përmbyllur procedurat e prokurimit për pajisje elektronike (kompjuter, laptop printer, ups, etj) në vlerën 780 mijë lekë dhe pajisje dhe mobilje zyre në vlerën 575 mijë lekë.

Diferencat që vihen re në realizim për këtë kategori shpenzimesh lidhen me vlera të kursyera gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Bashkëlidhur lutemi të gjeni formatet standarde për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar - dhjetor 2022.

Duke ju falënderuar,